

# Manual i Zhvillimit të Kapaciteteve të të Rinjve për Avitvizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

Ky manual është zhvilluar nga ekspertja e Qendrës Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim në kuadër të projektit “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” të mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë.

Ky manual bazohet në praktika të mira dhe i referohet dokumenteve të tjerë dhe shërben si bazë për setin e trajnimeve për zhvillimin e kapaciteteve të të rinjve në Tiranë, Korçë dhe Shkodër.

Të drejtat e manualit qendrojnë me Qendrën Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim

Tiranë, Dhjetor 2021

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

## Programi i zhvillimit të kapaciteteve të të rinjve

*Rreth projektit*

### Titulli i projektit

*“Nga fjala tek veprimi – Aktivizim për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë”*

*Organizatrat implementuese*

1. Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim ([SciDev](#))
2. Rrjeti Erasmus në Shqipëri ([ESN Albania](#))
3. Qendra për Studime të Krahasuara dhe Ndërkombëtare ([QSKN](#))

*Fokusi gjeografik: Korça, Shkodra, Tirana*

### Synimi/Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit është që të fuqizojë të rinjtë në Tiranë, Korçë dhe Shkodër për të qenë aktiv në komunitetin e tyre me fokus punën rinore përmes përdorimit të inovacionit dhe krijimtarisë për ndryshim shoqëror duke i përgatitur për të qenë të suksesshëm në sferën publike si edhe tregun e punës përmes zhvillimit të aftësive dhe kompetencave bashkëkohore dhe me vlerë të shtuar në realitetin post-COVID19.

### Rreth AKR

AKR është Agjencia Kombëtare e Rinisë e cila zbaton politikat rinore dhe siguron mbështetjen dhe përfshirjen e rinisë në çdo fushë social–kulturore. Qëllimi i saj është të mbështesë të rinjtë duke ngritur kapacitete dhe promovuar pjesëmarrjen e tyre në vendimarrje. Misioni i Agjencisë Kombëtare të Rinisë është garantimi i mbrojtjes dhe i promovimit të të drejtave të të rinjve, nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

## Qëllimet e programit të zhvillimit të kapaciteteve të të rinjve

- Aktivizimi publik i të rinjve
- Përdorimi i teknologjisë / digjitalizimi dhe krijimtarisë për aktivizim dhe pjesëmarrje
- Qytetaria aktive
- Mjetet digjitale dhe efektiviteti i tyre
- Llojet e ndryshme të aktivizmit dhe fushatave që mund të ndërmerren
- Hapat konkretë si të rinjtë mund të nisin aktivizmin e tyre

## Objektivat e mësimi

- Njohja me aktivizmin ku ka nisur dhe si ka evoluar ai me kalimin e kohës.
- Njohja me llojet e aktivizmit që përdoren sot më shumë nga të rinjtë.
- Njohja me rëndësinë që ka pjesëmarrja aktive e të rinjve dhe çfarë domethënie ka kjo për qytetarinë aktive.
- Njohja me hapat dhe cilësitë që duhet të kenë aktivistët e rinj parasysh kur nisin aktivizmin e tyre.
- Njohja me cilësitë të cilat duhet të kenë kauzat në mënyrë që të jenë të realizueshme.
- Njohja me disa nga platformat më të përdorura digjitale me pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe si të jenë të përgatitur rreth sfidave që mund të hasen.

## Metodologjia e trajnimit

Trajnimi përfshin njohjen me origjinën e aktivizmit, mënyrave si ai zhvillohet sot dhe cilat janë platformat më të përdorura në aspektin offline si edhe atë online si edhe cilat janë hapat kryesorë para ndërmarrjes së një aktivizmi. Në të trajtohen shembuj suksesi lokalë dhe ndërkombëtarë dhe cilat janë karakteristikat që kanë bërë ato të kenë sukses. Gjithashtu do të përfshihen dhe pikat e forta dhe të dobëta të strategjive në mënyrë që aktivistët e rinj të mos gjenden të papërgatitur përballë sfidave. Në këtë trajnim do të kryhen prezantime me rekomandime dhe mënyrës se si mund të niset rruga e një aktivizmi dhe si mund të ndërthuren gjithë metodat për të patur një rezultat final të suksesshëm.

## Profili i të rinjve

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

Të rinjtë e përfshirë në trajnim janë studentë të universiteteve të qyteteve të Tiranës, Korçës dhe Shkodrës nga ciklet e studimeve Bachelor dhe Master. Të rinjtë kanë një moshë prej 18-25 vjeç. Për një pjesë të tyre kjo mund të jetë hera e parë që të jenë pjesëmarrës të një fushate angazhimi çka hedh rrënjët e aktivitetit të ata në të nesërmen për të reaguar për çështjet që ata i shqetësojnë në realitetin post COVID-19. Ky reagim do të jetë i pasuruar me njohuri dhe kompetenca të reja që do ti ndihmojnë ata për konsolidimin e ideve të tyre në praktikë. Në këtë mënyrë ata jo vetëm reagojnë, por bëhen më të përgatitur rreth nisjes së karrierës së tyre si në sektorin publik ashtu edhe privat.

### Temat specifike

- Çfarë është aktivizmi dhe si ka lindur
- Rëndësia e pjesëmarrjes së të rinjve
- Çfarë është aktivizmi online?
- Si duhet të jenë kauzat në mënyrë që të jenë të suksesshme
  
- Rruga e Aktivizmit
- Llojet e aktiviteteve që mund të bëhen për aktivizmin e të rinjve në terren
- Aktivizmi artistik
- Aktivizimi në komunitet përmes punës vullnetare
- Si mund të bëjmë angazhimin online në një aktivizëm konkret?
- Platformat më të përdorura
- Disa mënyra për të realizuar një angazhim konkret nga aktivistët e rinj duke përdorur platformat
- Disa ide të aksioneve konkrete të mediave sociale që mund të tërheqin vëmendjen për kauzën e aktivistëve
- Disavantazhet dhe pengesat që mund të shfaqin rrjetet sociale
- Faza finale dhe reagimi
- Përfundime dhe rekomandime
- Referenca

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

## Çfarë është aktivizmi dhe si ka lindur?

Nënshtrimi, pabarazia, revolucioni dhe protesta kanë shënuar historinë botërore për mijëra vjet dhe për mijëra vjet, qeniet njerëzore kanë luftuar shtypjen dhe nënshtrimin – si me dhunë ashtu edhe në mënyrë paqësore. Historia na jep shembuj të fushatave që ndryshuan peizazhin gjeopolitik edhe te ato raste që edhe pse qenë të pasuksesshme, theksuan shtypjen.

Në Shtetet e Bashkuara, por edhe Europë aktivizmi paqësor ka qenë, në pjesën më të madhe, themeli i protestës. Fokusi kryesor i protestës për gati 200 vjet në SHBA ishte shtypja e të drejtave për miliona njerëz me ngjyrë të mbajtur në skllavëri dhe më vonë mohimi i të drejtave të barabarta; dhe statusi dytësor i grave. Ndërsa në Europë lëvizjet ishin të herëpërsëherme rreth të drejtave të punëtorëve, taksave si edhe padrejtësive.

Ndonëse lëvizje të mëdha shoqërore kanë shoqëruar njerëzimin që në nisje të tij aktivizmi si fenomen ka filluar të trajtësohet në këto [100 vitet e fundit](#). Një aktivist është një person që bën fushatë për një lloj ndryshimi shoqëror. Dikush që është i përfshirë në mënyrë aktive në një protestë civile, në një protestë politike ose sociale mund të quhet një aktivist. Demonstratat, grevat dhe protestat janë disa nga mënyrat se si një aktivist mund të punojë drejt ndryshimit që ai beson. Rrënja e fjalës aktivist rrjedh nga latinishtja *actus*, “[një veprim, një forcë lëvizëse, ose një impuls](#).” Dikush që vepron sipas asaj që ai beson është [aktivist](#).

Të gjithë ne shohim lëvizje të ndryshme për çështje që shqetësojnë komunitetin që nga pastërtia e qytetit, ndryshimet klimatike, shpronësimet jo të drejta, mungesë subvencionesh, krime makabre etj. Shumë prej nesh mund të jemi në një bindje me banorët e tjerë që angazhohen, por nuk e shprehim këtë duke qëndruar neutralë, por cilat mund të jenë disa nga arsye që shtyjnë njerëzit të bëjnë aktivizëm?

Aktivistët zgjedhin të marrin kauza për një shumëllojshmëri të gjerë arsyesh dhe disa janë jo aq të drejtpërdrejta sa mund të duken. Ata që gjejnë kuptim personal në ngjarjet aktuale janë të prirur të flasin për to. Individët kanë më shumë gjasa të ndiejnë një lidhje personale nëse ata e shohin veten si pjesë e komunitetit të prekur nga një çështje. Lëvizjet e grave p:sh e përqafuan këtë ndjenjë të identitetit kolektiv. Disa psikologë thonë se shumica e akteve të altruizmit, të përcaktuara si përkushtim ndaj interesave të të tjerëve në fakt buron nga dëshira për të ndihmuar veten. Duke folur në mënyrë aktive për të tjerët mund të krijojmë ndjenjën e ndjeshmërisë. Aktivizmi është një mënyrë në të cilën jemi duke ndryshuar botën përreth nesh dhe duke bërë komunitetet tona, lagjet, shkollat, vende më të mira. Na lejon për të formuar mjedisin tonë sipas

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

nevojave dhe imagjinatës tonë. Aktivizmi rinor është më i rëndësishmi pasi të rinjtë futin energjinë, kreativitetin dhe inovacionin në proces. Askush nuk mund të kontribuojë me karakteristikat e ndryshimit, si munden ata. Të rinjtë janë ata imagjinata e të cilëve nuk është e lidhur me [kufizime sociale dhe krijimtaria e tyre shkon larg nga zona e tyre e komfortit](#).

### **Rëndësia e pjesëmarrjes së të rinjve**

Pjesëmarrja e të rinjve është një proces i arritjes së ndryshimeve pozitive në jetën e tyre dhe i ndërtimit të një komuniteti dhe shoqërie më të mirë. Mjetet për ta arritur atë janë të ndryshme: nisma, aktivitete, projekte që nxisin përfshirjen e të rinjve në nivele shumë të ndryshme – lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ekzistojnë teori të ndryshme që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e të rinjve dhe mund të trajtohen nga këndvështrime të ndryshme në varësi të kontekstit, sfondit etj. Është e rëndësishme të kihet parasysh motivimi i aktorëve të ndryshëm si shoqëria civile, organizatat politike, organizatat rinore gjithashtu mund të ndryshojnë orientimin rinor. Pjesëmarrja në jetën demokratike të çdo komuniteti ka të bëjë më shumë sesa votimi apo zgjedhjet, edhe pse këto të fundit janë elementë të rëndësishme. Pjesëmarrja dhe qytetaria aktive është e drejta për të pasur mjetet, hapësirën dhe mundësinë për të reaguar dhe kërkuar transparencë aty ku është e nevojshme. Të qenit një qytetar aktiv do të thotë të kërkosh mbështetje për të marrë pjesë në vendime, veprime dhe aktivitete dhe të kesh një ndikim në këtë pjesëmarrje pasi në këtë mënyrë mund të kontribuojmë në ndërtimin e një shoqërie më të mirë. Qytetaria aktive është një term që përdoret për të përshkruar përfshirjen e individëve në jetën publike që mund të zhvillohet në vend, rajon në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare.

### **Çfarë është aktivizmi online?**

Aktivizmi online e ka pikënisjen e tij në fillim të viteve 90 -të me fushatën e dërgimit të emaileve në masë, por vitet e fundit është fuqizuar edhe më shumë. Interneti është bërë katalizator për protesta të mëdha si p.sh [Okupimi i Wall Street-it dhe Pranverës Arabe](#). Ai ka ndihmuar që njerëzit të qëndrojnë të përfshirë duke u mbështetur gjithnjë e më shumë në mediat sociale. Këto të fundit kanë bërë edhe që njerëzit të organizohen dhe të qëndrojnë të lidhur me njëri tjetri në kohë reale. Është argumentuar shpesh se interneti ka ndryshuar jetën e përditshme e njerëzve, ndryshoi mënyrën se si ne mësojmë, gjejmë lajme, mënyrën si bëhen bizneset etj.

Mediat sociale u bënë pjesë përbërëse e jetës së njerëzëve, duke u dhënë atyre mundësi për të zhvilluar dhe shprehur më tej identitetin e tyre. Megjithatë, duhet pohuar se aktivizmi online ka një ndikim të rëndësishëm në zvogëlimin e aktivizmit që zhvillohet në terren. Kjo ndodh kryesisht

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

sepse organizatat dhe individët që nxisnin aktivizmin në të kaluarën, nuk kanë qenë të përgatitur për këtë trend të ri. Rrjetet sociale janë një mjet shumë i fuqishëm për nxitjen e aktivizmit, sidomos të rinjve, të cilët kanë vërtetuar se kanë ndryshuar rrjedhën dhe tronditur situatat në shumë vende të botës.

Nga të dhënat e vetë platformave duket se të rinjtë shpenzojnë kohë të shumtë në këto rrjete që mund të formësojnë opinionin dhe qëndrimin e tyre për çështje të caktuara ndaj këto rrjete nuk duhet të konceptohen më vetëm në kuadrin e argëtimit. Studiuesit janë të ndarë nëse interneti do të rritet apo do të çrregullohet. Përfshirja në aktivizmin online ka rritur pjesëmarrjen politike. Ata që sugjerojnë se pjesëmarrja politike do të rritet besojnë se interneti mund të përdoret për të rekrutuar dhe komunikuar me më shumë përdorues, pasi ofron kosto të ulëta. Mënyrat e pjesëmarrjes kushtojnë zakonisht për ata që u mungon koha ose motivimi. Nga ana tjetër përpos benefiteve duhet të kemi në konsideratë se interneti mund të sjellë edhe uljen e aktivizmit dhe kjo argumentohet me faktin se interneti zë kohën e lirë që mund të mos shpenzohet më për t'u përfshirë në grupe aktiviste. Edhe sot kur duket se çdo gjë është online 60% e popullsisë së botës nuk është online dhe se disa nga revolucionet virtuale po kalojnë të pazbuluara dhe ngremë pyetjen nëse vërtet mund të kemi një revolucion përmes internetit? Sido që të jenë pyetjet, apo shqetësimi, aktivistët janë mes nesh dhe tani, në kohën e sotme, jemi duke folur gjithnjë e më shumë për aktivistët online. Jetojmë në epokën kur një blog mundet të nisë një revolucion.

Shumë prej nesh janë dhe mund të jenë përcjellës të mesazhit ashtu si media. Me një numër të madh të rinjsh që kanë mbi 500 ndjekës, miq dhe vëzhgues në profilet e tyre në internet, ekziston një mas-audiençë aktive dhe shtrirje për të krijuar ndryshime potenciale si në botën virtuale ashtu edhe në atë reale. Me revolucionin teknologjik të telefonave celularë, shumë prej të rinjve kanë një shans akoma më të madh për tu bërë më të shpejtë dhe në disa raste më të mirë se media. Ka lloje të ndryshme të aktivistëve në internet dhe rolet e ndryshme që ata mund të marrin si: "liderë kibernetik", "përcaktues të tendencave", "opinionbërës", "ndjekës", "aktivistë të kolltukut", "shpërndarës", etj, por cilindo rol që ata marrin, mund të jenë pjesë të një kauze dhe të jenë iniciues të ndryshimeve.

Ata nuk kanë nevojë domosdoshmërisht të shkojnë në terren, ata nuk kanë nevojë të bëjnë kërkime derë më derë, apo të bëjnë greva e protesta masive pasi epoka digjitale ka zgjeruar jashtëzakonisht hapësirën për aktivizëm dhe kreativitet, dhe të rinjtë që veprojnë si media janë pararendësit e këtij rendi botëror të ri. Nëse "aktivizmi online" mund ta ndryshojë vërtetë botën, kjo është një pyetje që ende qëndron. Në një anë do të pohojmë se "po" pasi kjo është provuar

*Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështetet nga:*



në shumë raste kur thirrjet për veprim në rrjet krijuan lëvizje. Kjo gjithashtu mund të provohet nga fakti që ka shumë blogerë që vuajnë dënimin me burg për shkak të aktivizmit të tyre online kundër qeverive përkatëse (p.sh. blogerë nga Azerbajxhani, Etiopia etj). Para se të kalohet në metodat konkrete të aktivizmit duhet të njihen karakteristikat e kauzave që të rinjtë mund të ndërmarrin në mënyrë që të kenë një produkt final të kënaqshëm.

### Si duhet të jenë kauzat në mënyrë që të jenë të suksesshme?

- **Specifike.** Është e rëndësishme që kauzat e fushatave të jenë sa më specifike të jetë mundur në mënyrë që të rinjtë të kenë kontrollin e përcaktimit të suksesit. Krijimi i kërkesave specifike kërkon bërjen e disa kërtimeve për të kuptuar se si të përmbushen më së miri nevojat e komunitetit, por siguron edhe kontroll më të madh në përcaktimin e mënyrës se si do të zbatohet [fushata](#).

**Të matshme.** Është e rëndësishme të vendosen kritere konkrete për matjen e progresit në përmbushjen e secilës pikë. Vendosja e standardeve të matshme ndihmon në qëndrimin në rrugën e duhur dhe tregon se aktivistët do të jenë në gjendje të artikulojnë qartë se si po ecin drejt përmbushjes së pikave të kauzës së tyre.

**Të arritshme.** A janë kauzat që do të ngrihen diçka që njëri mund të bashkohen vërtetë? Duke patur vizione të mëdha, por jo veprime konkrete askush nuk mund të mbajë përgjegjësi për marrjen e masave. Në vend të vizionit duhet të krijohen veprime më të arritshme dhe specifike duke përfshirë mbase fushata dhe ndërgjegjësim të fokusuar në grupe të vogla. Ndoshta vizioni nuk mund të realizohet, por rezultatet nga veprimet konkrete të trajnimeve apo aktiviteteve që mund të zhvillohen janë të arritshme dhe të matshme dhe dikush mund të mbahet përgjegjës.

**Realiste.** Një kauzë duhet të jetë e menduar në një formë të atillë që aktivistët e rinj të jenë të gatshëm dhe të aftë për të punuar drejt. Kjo nuk do të thotë kauza duhet menduar e vogël pasi në fakt, më shumë njerëz shpesh janë të gatshëm për të punuar drejt kërkesave që janë më të vështira, por që do të kenë një ndikim më të madh në komunitet.

**Në kohë.** Kauzat duhet të bazohen brenda një afati kohor. Një nga taktikat më të mira të vendimmarrësve për të shmangur kërkesat dhe transparencën e kërkuar nga aktivistët e rinj në rastin kur kauza e tyre lidhet me instanca është t'i vonojnë ato. Në vend të refuzimit të tyre shumica e vendimmarrësve do të përpiqen t'i qetësojnë aktivistët duke thënë se ata kanë nevojë për kohë për t'u marrë parasysh, zakonisht mjaft të gjatë. Prandaj, është jashtëzakonisht e

*Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështetet nga:*

rëndësishme që të përcaktohet se kërkesat e kauzës janë përmbushur deri në një datë të caktuar. Kjo krijon një ndjenjë “urgjence” që është vendimtare për të çuar veprimin deri në fund.

## **Rruga e Aktivizmit**

### **Hapi 1**

*Identifikimi i problemit dhe çfarë kërkon zgjidhje.*

Cila çështje kërkon ndërhyrje të shpejtë pasi është shqetësuese. Specifikimi i shkakut dhe origjinës së problemit.<sup>1</sup>

### **Hapi 2**

*Vendosja e synimeve dhe objektivave.*

Pas renditjes së shkakut dhe pasojave që problemi po shkakton në komunitet, shoqëri, vend duhen vendosur objektiva dhe synime se çfarë do të arrihet me zgjidhjen e problemit dhe mënyrës se si do të realizohen. Këto pika duhet të jenë të qarta, konkrete dhe të realizueshme.

### **Hapi 3**

*Identifikimi i vendimarrësit.*

Me cilat instanca lidhet problemi. A janë ata adekuatët që mund të ndikojnë në zgjidhjen e tij. A janë ata të aksesueshëm dhe sa të gatshëm mund të tregohen në zgjidhjen e kauzës.

### **Hapi 4**

*Përcaktimi i mesazhit*

Duhet realizuar një motiv apo një mesazh kryesor që kauza për të cilën veprohet do të përçojë si edhe duhen përcaktuar veprimet kryesore që situata të ndryshojë në një mënyrë që të përcillet mesazhi dhe zgjidhja që problemi ka nevojë.

### **Hapi 5**

---

<sup>1</sup> Edlira Gjoni-Qeverisja dhe angazhimi qytetar- Akademia e Aktivizmit III FES TIRANA

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

### *Përcaktimi i afateve kohore.*

Në mënyrë që aktivizmi të jetë i suksesshëm duhet mirëpërcaktuar koha e veprimit dhe të planifikohen aktivitetet që do të realizohen. Kryerja e aktiviteteve brenda afateve të parashikuara sjell një koordinim më të madh dhe rrit shanset e suksesit të fushatës.

#### Hapi 6

### *Vlerësimi dhe vënia e planeve në zbatim.*

Pas gjithë përcaktimeve të qarta të hapave paraardhës duhen përcaktuar metodat dhe mënyrat që do të përdoren në zbatimin e planit. Në këtë fazë duhet të jetë e qartë rruga që do të ndiqet dhe të zbatohen rigorozisht hapat e përcaktuar më parë. Gjatë kësaj faze do të implementohet puna dhe veprimi konkret për kauzën duke shfrytëzuar edhe resurset e reja që mund të dalin gjatë rrugës.

#### Hapi 7

### *Vlerësimi i punës dhe ndarja e rezultateve*

Pas implementimit të planit duhet të vlerësohet i gjithë procesi dhe të kryhet një rezymë përmbledhëse e gjithë punës. Ky produkt i cili mund të jetë i formave të ndryshme që tregon advokimin dhe mesazhin e kauzës. Ky produkt përmban gjithë hapat e ndërmarrë dhe mënyrën e realizimit si edhe cilat metoda janë arritur në realizimin e rezultateve. Ky produkt mund të shpërndahet më tej në forma të ndryshme qoftë në media sociale apo edhe në anën mediatike duke qenë një dëshmi e gjithë aktivistëve duke shërbyer edhe si një pikë referimi për fushatat e tyre të ardhshme të aktivizmit.

### **Llojet e aktiviteteve që mund të bëhen për aktivizmin e të rinjve në terren**

Në masën e gjerë aktiviteti më domethënës dhe që mund të vijë në mendje menjëherë është aktivizmi në terren. Ky i fundit u lejon studentëve të angazhohen në një veprim konkret, duke fuqizuar idetë dhe vetëbesimin e tyre si edhe rrit fuqinë e aktivizmit të të rinjve. Pjesa më e madhe e aktivizmave të këtij lloji janë të fokusuar në rritjen e ndërgjegjësimit për njerëzit, duke vënë në dukje disa problemeve ose në kryerjen e disa kërkimeve që mund të shpërndahen më tej përmes ndonjë veprimi apo nisme konkrete që mund të prezantohet fillimisht në një medium social dhe më tej tu paraqitet edhe institucioneve përkatëse të cilat mund të jenë më kompetente

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

rreth zgjidhjes së [problemimit](#). Siç u përmend më lart, kjo metodë dhe mund të mbështetet nga shoqëria si edhe nga mjetet e medias qoftë sociale apo kanalet televizive me më shumë audiencë, duke marrë mbështetje për një ide për të arritur te masa më të mëdha. Pika më e fortë e këtij lloji aktivizmi qëndron në faktin se ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi njerëzit e tjerë, shumë më tepër se metodat e tjera dhe rastet në botë kanë dëshmuar suksesin e saj. Disa nga aktivitetet të cilat mund të zbatohen në terren janë:

1. Performanca (koreografi me mesazhe, vrapim, marshim, recitime, koncerte)
2. Protesta
3. Vepra artistike (piktura, karikatura, skulptura, murale, grafitë)
4. Punë në komunitet (pastrim, mbjellje pemësh, rregullim, zbukurim, mbledhje të ndihmave për shtresat në nevojë)

### **Aktivizmi artistik**

Aktivizmi i lidhur me format krijuese të të shprehurit ka qenë gjithmonë shumë më i suksesshëm në transferimin afatgjatë të mesazheve kuptimplotë dhe për këtë arsye ai përcjell shumë njohuri. Për më tepër, shpejtësia në të cilat të rinjtë i marrin, i analizojnë dhe procesojnë informacionet sot është shumë më e lartë në mesazhet vizuale. Arti në vetvete mund të jetë një nxitës shumë i mirë i aktivizmit të të rinjtë kjo pasi përfshirja në aktivitete të tilla mund të fuqizojë kreativitetin e shprehjes dhe zhvillimit të imagjinatës, e cila mund të çojë drejt qasjeve inovative në zgjidhjen e problemeve dhe sjell një advokim të madh për çështjet shqetësuese të përditshme. Shumë prej këtyre veprave të artit mund të kenë ndikim edhe më të madh nëse behen virale më pas. Një nga shembujt më domethënës në botë në shekullin XXI është Banksy. Grafitet e tij unike dhe krijuese kanë synuar të tërheqin vëmendjen në disa prej çështjeve më të rëndësishme morale, ekonomike sfidat politike dhe sociale në botë, dhe u bënë të njohura globalisht. Nëse mund të krijohen postera të bukur, muzikë ose performanca do të jenë edhe vetë kuratorët e medias ata që do të kërkojnë shpërndarjen e këtyre iniciativave pasi siç është e njohur tanimë ata janë në kërkim të përmbajtjeve interesante për ti ndarë me [shikuesit](#). Për audiencën, arti mund të tërheqë dëgjuesin ose shikuesin në nivelin ndijor që i ndihmon ata të kuptojnë çështjen në një mënyrë të re. Ashtu si tregimet, përdorimi i artit është veçanërisht i rëndësishëm kur punohet për të krijuar ndryshim kulturor në nivel lokal apo kombëtar sepse kjo ndihmon në gjenerimin e kuptimit të [shoqërisë tonë](#). Është e rëndësishme të tregohet kujdes për procesin krijues kur bëhet art. Llojet e artit që po përdoren kryesisht në aktivizmin rinor janë:

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

- Ilustrimi dhe dizajni i përdorur në fletëpalosje, pankarta, kartolina, ngjitëse, postera, projektme në muret e ndërtesave etj
- Grafikë, meme ose gif të animuara të përdorura në rrjetet sociale, media
- Murale me përmasa të mëdha të bëra me bojë ose shkumës
- Fotografitë e përdorura në mediat sociale, në ekspozitat e galerive, ose në botime
- Krijimi i filmave për ti shfaqur në mediat sociale, faqet e internetit ose në kinema
- Muzikë, këngë dhe podkaste të regjistruara ose të luajtura në radio lokale
- Shfaqje teatri, skeçe dhe skeçe komedie në hapësira publike, në teatro ose të shpërndara me video në internet
- Klipe kërcimi dhe shfaqje muzikore me një mesazh specifik
- Origami ose arte të tjera letre që përdoren për të krijuar skulptura
- Moda dhe shfaqjet performuese me një kauzë specifike

### **Aktivizimi në komunitet përmes punës vullnetare**

Akti i të qenurit vullnetar është një shprehje e lirisë, duke reflektuar ndjeshmërinë për nevojat e të tjerëve dhe shpesh duke përfshirë sakrificën personale. Vullnetarizmi është vendimi për të vepruar sipas nevojës, me përgjegjësi shoqërore dhe pa menduar në përfitim financiar, duke shkuar përtej obligimeve personale. Aksioni vullnetar është gurë themel i angazhimit qytetar. Vullnetarizmi përfshin përgjegjësinë qytetare. Ai rrit pjesëmarrjen qytetare dhe vendim-marrjen në çështjet që ndikojnë në jetën e komunitetit. Vullnetarizmi kontribuon në zhvillimin e kulturës së reciprocitetit dhe të solidaritetit. Rritja e vullnetarizmit është tregues i një ndërveprimi të zgjeruar midis shtetit dhe qytetarisë së saj. Për shoqërinë, vullnetarizmi mund të krijojë liderë<sup>2</sup>. Nëpërmjet vullnetarizmit, të rinjtë njohin pjesë të komunitetit që ata nuk do të mund t'i hasnin ndryshe duke i shtyrë shpesh të ndërrojnë rrugën e karrierës për të punuar në një lëmi që i shërben të mirës së përbashkët si shëndetësia, arsimi dhe shërbimet sociale – sektorë që kanë nevojë për liderë vizionarë. Vullnetarizmi si akt thelbësor të qytetarisë, një mjet për luftimin e marginalizimit apo përjashtimit dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike. Në raportet e 'Ameri-Corps', thuhet se vullnetarizmi rrit besimin e njerëzve në aftësinë për të punuar me qeverinë lokale dhe qendrore. Vlerësimet sugjerojnë se vullnetarizmi kontribuon nga 0.5% deri në më se 5% të Prodhimit Bruto Nacional të vendeve të BE-së. Në Bashkimin Evropian, përafërsisht 100 milion qytetarë të të gjitha grup moshave investojnë kohën, talentin dhe paratë

<sup>2</sup> V.Bytyçi. Aktivizimi në komunitet përmes punës vullnetare- Akademia e Aktivizimit III FES TIRANA

*Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështetet nga:*

e tyre për të kontribuar pozitivisht për komunitetin në organizata të shoqërisë civile, klube të rinjve, spitale, shkolla, klube të sportit dhe në aktivitete të ngjashme. Sipas Qendrës 'Johns Hopkins' për Studimet e Shoqërisë Civile, brenda një viti rreth 140 milionë njerëz në 37 vende të botës angazhohen në punë vullnetare. Është vlerësuar se vullnetarët kontribuojnë rreth 400 miliardë dollarë në ekonominë globale çdo vit. Aktivitetet vullnetare realizohen në disa sektorë të ndryshëm. Në më shumë se gjysmën e vendeve të BE-së, shumica e vullnetarëve janë aktiv në fushat e sportit, ushtrimeve dhe aktiviteteve në ajër të pastër. Fusha të tjera të përhapura janë mirëqenia sociale dhe shëndeti, bamirësia dhe organizatat fetare, organizatat kulturore, rekreacioni dhe koha e lirë, organizatat arsimore, trajnimet dhe hulumtimet e ndryshme. Duke jetuar në një dekadë të një revolucioni teknologjik sigurisht që anagzhimi në terren ka vlerën e tij dhe është i pazëvendësueshëm, por tanimë duket sikur aktivizmi është kanalizuar më tepër te angazhimi online dhe më poshtë janë disa nga mënyrat e përdorimit të tij në aktivizmin e të rinjve sot.

### **Si mund të bëjmë angazhimin online në një aktivizëm konkret?**

Edhe pse duke jetuar në një epokë me shumë të përbashkëta edhe vetë të rinjtë ndonjëherë shfaqen skeptikë rreth efektshmërisë që do të ketë aktivizmi online. Shpeshherë ata vetë duke qenë dhe përdoruesit më të shumtë të rrjeteve bëjnë debate në lidhje me to më njëri tjetrin. Shembuj të deklaratave provokuese që mund të përdoren për të hapur temën e pjesëmarrjes dhe aktivizmit online mund të jenë:

- *"Pjesëmarrja online nuk është pjesëmarrje reale".*
- *"Çfarë ndodh në internet, qëndron po aty".*
- *"Shpërndarja nuk është pjesëmarrje e vërtetë".*
- *"Asnjë produkt i vërtetë nuk mund të dalë nga peticionet online".*
- *"Revolucioni mund të fillojë me një blog".*
- *"Unë kurrë nuk paraqitem vërtet në ngjarjet për të cilat kam nënshkruar në internet".*
- *"Ata janë thjesht "njerëzit nga interneti".*
- *"Çdo gjë që shkruhet në internet është e vërtetë".*

Këto janë vetëm disa shembuj që mund të përdoren për diskutim në lidhje me pjesëmarrjen në internet dhe përhapjen interaktive të debatit mes pjesëmarrësve. Sa më provokuese të jenë deklaratat aq më përmbajtësor dhe më i mirë do të jetë [debat](#)i. Kjo metodë mund të përdoret

*Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështetet nga:*

për tema të ndryshme, por cilat janë metodat më të përdorura sot për sot për ndryshim të shpejtë?

### Platformat më të përdorura

- Peticionet online.

Faqet e internetit të tilla si Change.org, ipetitions.org, Avaaz.org janë qendra të aktivizmit në internet, ku njerëzit mund të komunikojnë me të tjerët në mbarë botën në lidhje me kauzën e tyre.

- Rrjetet sociale.

Faqet me numër të lartë përdorimi si Facebook dhe YouTube kanë dëshmuar të jenë mjaft të dobishme në përhapjen e një mesazhi, mbledhjen e mbështetjes, hedhjen dritë mbi një temë që përndryshe mund edhe të anashkalohej nga [mediat kryesore](#).

- Facebook

Fillimisht i krijuar për të lidhur studentët e kolegjit në kampuset anembanë Shteteve të Bashkuara, Facebook është bërë shpejt një rrjet social mbarëbotëror me një sërë veçorish të dobishme për aktivizmin dixhital. P:sh Facebook u lejon përdoruesve të krijojnë grupe të dukshme dhe private që ndihmojnë aktivistët dhe mbështetësit e tyre të ndajnë informacionin dhe të koordinojnë përpjekjet e tyre. Grupet në Facebook ndihmojnë gjithashtu kauzat dhe organizatat të gjejnë mbështetës të rinj dhe të bashkojnë burimet e tyre kur është e nevojshme.

- Instagram.

Për shumë njerëz, Instagrami është bërë një nga burimet kryesore për të marrë lajme. Aplikacioni i lejon përdoruesit të ndajnë shpejt dhe me lehtësi përmbajtjen me ndikim vizual, duke e bërë atë një mjet jashtëzakonisht të aksesueshëm për aktivistët. Aktivistët dixhitalë mund të krijojnë profile që mbështetësit të ndjekin dhe të shpërndajnë shpejt lajmet përmes burimit kryesor ose mesazheve të drejtpërdrejta. Natyra e platformës ka bërë që aktivistët dixhitalë të postojnë informacione në forma që ngjajnë shumë me fletushkat e printuara nga epokën para internetit, duke i dhënë asaj një prekje paksa më të afërt ose personale se platformat e tjera. Instagram gjithashtu i lejon përdoruesit të postojnë video dhe të transmetojnë drejtpërdrejt live. Aktivistët e kanë përdorur këtë si një mënyrë për të dokumentuar punën e tyre, për të dhënë prova vizuale të suksesit dhe pjesëmarrjes së tyre në evente dhe tubime.

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

– Snapchat

Ky aplikacion i mediave sociale lejon përdoruesit të postojnë foto, video dhe tekste që janë të disponueshme për ndjekësit e tyre vetëm për një kohë të kufizuar. Aktivistët dixhitalë kanë përdorur Snapchat për të krijuar fletushka duke përdorur gjeofiltrat e programit dhe dizajnet e personalizuar për postimet e tyre. Për më tepër, Snapchat i lejon përdoruesit të krijojnë "histori" me video që etiketojnë gjeografikisht se ku ndodhet përdoruesi dhe u mundëson përdoruesve të tjerë brenda një zone të afërt të kontribuojnë me postime. Ky aktivizëm funksionon mirë për ngjarje si konferenca, protesta dhe demonstrata.

– Twitter:

Një nga burimet kryesore të lajmeve për shumë njerëz në mbarë globin, Twitter shërben si një qendër informacioni në kohë reale për aktivistët dhe mbështetësit e tyre. Megjithëse ka shumë veçori të njëjta si burimi i lajmeve të Facebook, Twitter ishte një nga faqet e para të mediave sociale që lidhi postimet e dukshme publikisht duke përdorur veçorinë "hashtag". Për shembull, nëse një përdorues bën një postim dhe përfshin hashtagun #, postimi do të përfshihet në një listë të dukshme publikisht ose furnizim të të gjitha postimeve që përfshijnë të njëjtin etiketë. Aktivistët mund të përdorin hashtag dhe (retweet), me ri-postimin e postimit të dikujt tjetër, për të ndihmuar në shpërndarjen e informacionit, për të fituar ndjekës, për të gjetur aktivistët me të njëjtin mendim që punojnë në fusha të ngjashme dhe për të organizuar shpejt protesta, bojkotime dhe organizime.

– YouTube

Shumë aktivistë sot zgjedhin të përdorin YouTube për të përcjellë mesazhin e tyre te masat, veçanërisht për ata që dëshirojnë të bëjnë postime që ndodhin rregullisht, të ndajnë lajme, video ose të transmetojnë drejtpërdrejt nga ngjarjet. Disa grupe dhe organizata e trajtojnë YouTube si një kanal lajmesh. YouTube shërben si një mënyrë e shkëlqyer për të përfshirë mbështetësit nga distanca, veçanërisht përmes pjesëmarrjes në distancë në transmetime të drejtpërdrejta. Disa aktivistë përdorin gjithashtu seksionin e komenteve në postimet në YouTube për të diskutuar çështje me shikuesit dhe për të gjetur mbështetës të tjerë. YouTube ofron funksionin e njohur "subscribe", i cili i lejon përdoruesit të marrin njoftime kur postoni përmbajtje të re.

• Hashtag

Në vijim të asaj që u përmend edhe me lart pasi hashtaget më së shumti përdoren në rrjetin social twitter, por përpos tij ato në fakt inkurajojnë përdoruesit e mediave sociale të eksplorojnë

*Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështetet nga:*



përmbajtjen që bie në sy. Aktivistët mund të përdorin hashtaget për të arritur audiencën e tyre të synuar dhe për të ndihmuar anëtarët të filtrojnë informacionin. Aktivizmi me hashtag shpesh mund t'i ndihmojë ata të organizojnë mitingje. Detaje të thjeshta si koha, datat dhe vendndodhjet mund t'i komunikohen lehtësisht një audiencë të gjerë nëpërmjet mediave sociale. Një Hashtag ndihmon për:

1. Vetëdijësimin
2. Ndërtimin dhe organizimin e komuniteteve
3. Jep një zë për ata që nuk mund të angazhohen
4. Edukimin
5. Rritjen e angazhimit qytetar
6. Tërheqjen e vëmendjes së medias

Përdorimi i një hashtagu ka treguar të jetë tejet dommethënës pasi p:sh në prill 2014, terroristët e Boko Haram rrëmbyen më shumë se 300 vajza nga një shkollë në Nigerinë veriore. Rreth 24 vajza arritën të arratiseshin, por 276 mbetën ende të kapura, duke shkaktuar një protestë ndërkombëtare që u dërgua kryesisht në një fushatë të mediave sociale për të lobuar te qeveritë për ndërhyrje. Hashtagu #BringBackOurGirls u bë viral brenda një jave, me njerëz si aktivistja Malala Yousafzai dhe Zonja e Parë e SHBA-së asokohe Michelle Obama, duke postuar mbështetjen e tyre në [Twitter](#). Shkalla e shpejtë e zjarrit që hashtag-u #BringBack OurGirls shkrepri në internet ndihmoi në nxitjen e mbështetjes publike për familjet e vajzave ndërsa rasti tërhoqi vëmendjen nga mediat ndërkombëtare dhe krerët e shteteve që u ofruan për të ndihmuar Nigerinë për të gjetur dhe rikthyer vajzat e zhdukura.

- Blogu.  
Në thelb një formë e gazetarisë qytetare për masat, blogjet ofrojnë një mjet efektiv komunikimi të pafiltruar me një audiencë për çdo temë dhe janë përdorur në fushata të shumta online. (metoo,blacklivesmatter)
- Mikro-blogging.  
Faqet e mikro-blogimit si Twitter përdoren për të ndihmuar në përhapjen e ndërgjegjësimit për një çështje ose ngjarje aktiviste. Funkcioni hashtag i Twitter, i cili siç u përmend u lejon njerëzve që tweet-et e tyre të kontribuojnë në një bisedë me shumë përdorues duke shtypur një fjalë kyçe ose frazë të paraprirë nga një hashtag, përdoret shpesh si një mjet dixhital për përhapjen e një mesazhi.
- Proxy servers.

*Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështetet nga:*

Si një mjet për të anashkaluar ndërhyrjen e qeverisë kur bëhet fjalë për protestat në internet, shumë njerëz përdorin serverë proxy, të cilët veprojnë si ndërmjetës midis një përdoruesi dhe një faqeje. Në vitin 2009, studentë protestues në Iran përdorën mediat sociale për të shprehur shqetësimin e tyre për rizgjedhjen e diskutueshme të [Presidentit Mahmoud Ahmadinejad](#). Kjo çoi në një ndjekje të qeverisë për përdoruesit duke u përpjekur të identifikonte se cilat media po përdorshin nga protestuesit për të komunikuar (rrjetet sociale dhe më pas serverët proxy) në mënyrë që të realizonin mbylljen e tyre.

- Platformat Crowdsourcing.

Duke përdorur internetin për të shpërndarë zgjidhjen e problemeve dhe përvetësimin e burimeve, këto platforma ndihmojnë individët dhe iniciativat për të mobilizuar një komunitet global dhe për të krijuar mundësi bashkëpunimi midis grupeve të njerëzve (përndryshe) të palidhur. Wikipedia është një shembull i mirë, si dhe platforma të njohura të financimit kolektiv si Kickstarter dhe Indiegogo.

## **Disa mënyra për të realizuar një angazhim konkret nga aktivistët e rinj duke përdorur platformat më lart:**

### *Hulumtimi në internet*

Aktivistët e rinj mund të bëjnë kërkime në internet mbi tema të ndryshme që ata i shqetësojnë dhe të përdorin të dhëna online për debat "pro" dhe "kundër" për disa çështje. Ata mund të ndahen në dy grupe, njëri përpiqet të gjejë argumente për të mbështetur p:sh temën me qëndrimin pro dhe grupi tjetër kundër, për të cilën ata mund të debatojnë më pas. Ky ushtrim ofron një përmbledhje të shkëlqyer rreth vlefshmërisë dhe neutralitetit që e gjejmë online dhe rezervimet që njerëzit kanë në lidhje me tema të caktuara. Pas këtij hulumtimi ata mund të përgatisin një raport të shkurtër me gjetjet për t'ua servitur të interesuarve duke patur një produkt konkret të punës së tyre.

### *Krijimi i mini-fushatave*

*Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështetet nga:*

Aktivistët mund të krijojnë mini-fushata në internet duke përdorur mediat sociale si pjesë simulimi të edukimit në mënyrë që ata të mund të praktikojnë përdorimin e këtyre mjeteve për shkaqet dhe fushatat e tyre të jetës reale. Ata mund të zgjedhin për të përdorur sa më shumë që të jetë e mundur media të ndryshme sociale - Facebook, Twitter, You-Tube, Instagram dhe të shohin se cila media është më e përshtatshme për kauzën e tyre. Në mënyrë që kauza të ketë sa më shumë shikueshmëri aktivistët e rinj duhet të venë idetë në praktikë, të jenë krijuar dhe të synojnë gjetje të mëdha. Këto të fundit ata mund ti marrin për të parë se çfarë do të funksiononte për kauzën e tyre se se cili do të ishte target grupi i tyre. Kjo metodë ka një vlerë të shtuar, pasi këto mini-fushata mund të jenë pjesë e vazhimit të veprimtarisë, e cila për shumë të rinj shpeshherë është problem për shkak të mungesës së fondeve dhe mbështetjes. Ato mund të sigurojnë qëndrueshmëri afatgjatë të projektit duke e përforcuar atë.

### *Tweet Walls*

Përdorimi i Tweeterit gjatë aktiviteteve advokuese mund të pasurojë diskutimet dhe të trazojë mendjet. Aktivistët mund të inkurajohen të postojnë në Twitter mendimet, idetë, reagimet e tyre dhe t'i postojnë ato duke përdorur hashtaget të përcaktuara për aktivitetin. Kjo është dëshmuar si një metodë shumë e efikase për ngjarjet në shkallë më të madhe, p.sh. konferenca, forume dhe organizime të tjera të ngjashme.

### *Blog ditor për reflektim*

Aktivistët mund të shkruajnë reflektimin e tyre të përditshëm blog në një faqe të dedikuar. Kjo mund t'u japë ndjekësve një pasyqërë të mirë mbi çështjet që aktivistët duan të trajtojnë si edhe rrit kënaqësinë e aftësitë e vetë të rinjve.

### *Përdorimi i hashtagëve*

Aktivistët mund të nisin punën e tyre me advokimin online duke përdorur fillimisht hashtaget më të thjeshta që përdoren në internet si (p.sh. # @ <3, etj.) Më tej duke parë se cilat nga elementët sjellin më shumë shikues dhe me shumë ndërvprime të mbahen për punën e mëtejshme.

### *Pëlqeje*

Elementë të ndryshëm të programit të punës mund të shkruhen në flip-chart dhe aktivistët mund mund t'i "pëlqejnë" ose "të mos i pëlqejnë" dhe t'i vënë atyre komente. Për këtë event mund të krijojnë një grupi i posaçëm në Facebook ose mund të përdoren sticky notes të cilat mund të

*Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështetet nga:*

printohen paraprakisht dhe tu jepen pjesëmarrësve për t'i përdorur për këtë rast. Kjo mund të ndihmojë në përmbledhjen e të dhënave dhe organizimin e një ndjekjeje adekuate të aktivitetit.

### *Organizimi i mbledhjeve në video-konferenca*

Në mënyrë që kauza të niset në një rrugë të mbarë duhet një koordinim dhe një komunikim i vazhdueshëm. Realizimi i mbledhjes dhe punës në grup mund të realizohet shumë mirë në platformat që e ofrojnë diçka të tillë si Zoom, Microsoft Teams, Google Meeting etj. Në këtë mënyrë rritet koordinimi dhe fuqizohen soft skills të aktivistëve.

### **Disa ide të aksioneve konkrete të mediave sociale që mund të tërheqin vëmendjen për kauzën e aktivistëve:**

- Ideja e parë dhe që të gjithëve ju vjen ndërmend është postimi i imazheve interesante të artit, fotografive, memeve, etj që mund të tërheqin shumë veprime ose pëlqime nga publiku. Për realizimin e këtyre të fundit mund të përdoren lehtësisht mjete si Canva.com ose Adobe Spark të cilat janë falas ose me kosto të ulët për krijimin e imazheve. Kur postimet marrin shumë komente dhe pëlqime, është një indikator se kauza po rezonon. Në këtë mënyrë kauza tanimë do të ketë kontaktet e para personat që ndërvepruan me përmbajtjen në rrjete sociale dhe mund tu kërkohet të vijnë në [takimin ose aktivitetin e ardhshëm](#).
- Krijimi i videove duke kërkuar nga mbështetësit të ndajnë të tyre historitë e tyre në kamera. Me anë të videove gjithashtu mund të transmetohen drejtpërdrejt eventet në Facebook dhe Instagram, ose postimi i drejtpërdrejtë në formën e tregimeve ose formës më të përshtatshme për kauzën. Gjithashtu përmes këtyre platformave mund të ftohen ekspertë për të folur mbi çështjet shqetësuese të kauzës ose mund të bëhet një telefonatë video-konferencë në site si Google Hangout. Mjetet si Apple iMovie ose YouTube Redaktor mund të shërbejnë si opsione me kosto të ulët për redaktimin e videove.
- Ndarja e lajmeve dhe fillimet e bisedave në faqet si Twitter dhe Facebook veprojnë si një mënyrë për të ndezur dialogun mes kauzës dhe mbështësve të saj dhe e bën atë më të dukshme dhe gati për të mirëpritur komente. Kjo ndihmon gjithashtu që faqet e mediave sociale të marrin angazhim të lartë si edhe rrisin shikueshmërinë e përgjithshme në internet të kauzës.

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

- Dokumentimi i veprimeve me foto dhe video të mbështetësve të kauzës ndihmon shumë në seriozitetin e saj. Në këtë rast mund të, postohen foto të mbështetësve jashtë në komunitet që po mbledhin nënshkrime peticioni, ose transmetim i drejtpërdrejtë nga një tubim i organizuar për të demonstruar fuqinë e kauzës. Mbështetësit mund të etiketojnë veten në foto dhe video në site sa herë që është e mundur për të ndihmuar në zgjerimin e shtrirjes në internet.
- Bërja e kauzës më të aksesueshme për personat që mund të mos jenë në gjendje të marrin pjesë në aktivitete personalisht. Personat me aftësi të veçanta ose që vuajnë nga sëmundje të ndryshme mund të përdorin mediat sociale për të marrë pjesë në kauzë virtualisht. Për videot që krijohen dhe postohen në mediat sociale, mund të përfshihen titrat sa herë që është e mundur për njerëzit me aftësi të ndryshme dëgjimi.
- Në mënyrë që kauzës ti jepet zë dhe mbështetje duhen kontaktuar personat me influencë në rrjetet sociale të mbështesin kauzën. “Influencers” ose organizatat më të mëdha mund të pyeten për të ndihmuar në promovimin e mesazhit të kauzës duke e mbështetur atë publikisht. Të famshëm, politikanë, mësues të admiruar, sportistë, personalitete të internetit, grupe studentore, grupet dhe sindikatat janë të gjithë shembuj të njerëzve që mund kenë ndjekës të mëdhenj në komunitet. Edhe thjesht një student të cilit njerëzit i besojnë mund të konsiderohet ndikues vendas. Kontakti me këta persona ndihmon së tepërmi kauzën në një kohë të shpejtë dhe më një numër të konsiderueshëm pasi siç vihet re nga trendet e sotme ndjekësit ka të ngjarë t'i besojnë miratimit të “influencerit” dhe të ndihmojnë më pas në [përhapjen e mesazhit](#).

### **Disavantazhet dhe pengesat që mund të shfaqin rrjetet sociale**

Rrjetet sociale mund të jenë jashtëzakonisht të dobishme në qarkullimin e shpejtë të mesazhit, por si çdo platformë komunikimi kanë disavantazhet e tyre. Këtu janë disa nga pikat që duhet të kihen parasysh kur ato përdoren për punën e advokimit:

- Mediat sociale janë një vend ku ngacmuesit kibernetikë janë të shpeshtë. Nëse ata qëndrojnë rreth kauzës, mundet të jenë demoralizues për kauzën. Nëse ata shfaqen dhe janë aktivë e mira për kauzën do të ishte që ata të bllokoheshin, ata gjithashtu mund të thjesht injorohen ose mund të përdoren për tu shpjeguar se pse kauza është vërtetë e nevojshme dhe e rëndësishme. Angazhimi me komente rrit shfaqjen e faqes në internet dhe kjo mund të përdoret në favor të [kauzës](#).

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

- Element tjetër që duhet të kihet parasysh gjatë aktivizmit në rrjetet sociale është ruajtja e privatësisë si për anëtarët që kryejnë dhe janë pjesë e skuadrës së aktivizmit ashtu edhe për pjesëmarrësit e tjerë që mbështesin kauzën. Ajo që shpërndahet në internet mund të jetë e vështirë të fshihet. Përgjithësisht faqet e rrjeteve sociale kanë cilësime të privatësisë që lejojnë rritjen ose uljen e ekspozimit në internet. Megjithatë, hakerët mund të jenë të zgjuar në depërtimin e sigurisë dhe gjithnjë e më shumë aktivistë po ngrenë shqetësime se si kompanitë e mediave sociale përdorin të dhënat. Për këto arsye është shumë e dobishme vlerësimi i pikëpamjeve të përdorimit të mediave sociale.
- Kryerja e një aktiviteti të ri mund të përfshijë shumë pjesëmarrësit dhe në këtë aspekt të krijojë edhe varësi të ta. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë se krijimi i ndryshimit kuptimplotë kërkon më shumë se postimet në rrjetet sociale. Organizimi kërkon ndërtim të marrëdhënieve me njerëzit në jetën reale. Rrjetet sociale nuk mund të sigurojnë një sukses të garantuar të kauzës, por janë ndihmuese dhe lehtësuese shumë të mëdha gjatë rrugës.

### Faza finale dhe reagimi

Pas shfrytëzimit të gjithë platformave të mësipërme dhe realizimit të produkteve të llojeve të ndryshme që nga raportet e deri te veprimet konkrete në komunitet dhe angazhim online mund të arrihet në fazën finale të aktivizmit. Kur bëhet fjalë për aktivizmin nuk ka gjë të tillë si humbja. Nëse ndodh një pengesë në gjatë implementimit të kauzës siç është një votim që nuk shkoi sipas parashikimeve ose objektivi nuk përputhet me pjesën e planifikuar që në fillim atëherë duhet që puna të rishikohet dhe të mos ketë ndjesi disfatizmi. Kur kauza arrin një fitore, puna nuk ndalet domosdoshmërisht atje. Në mënyrë që kauza të jetë konsistente dhe e suksesshme anëtarët duhet të qëndrojnë aktivë edhe pas realizimit të objektivave kryesore. Suksesi i kauzës dhe transmetimi i punës që u bë nuk duhet të jetë në konotacionin e punës së palodhur të grupit dhe të fokusohet vetëm aty por të flasë rreth përfitimit që do të ketë komuniteti nga ajo. Pra nuk duhet parë në aspektin vetjak, por në aspektin se si komuniteti do të përfitojë nga ky ndryshim. Një nga tiparet më thelbësore jo vetëm gjatë fazës finale, por gjatë gjithë punës është [dokumentimi](#). Mediat sociale mund të vazhdojnë të përdoren edhe në këtë fazë duke u shfrytëzuar për publikimin e rezultateve të kauzës. Ky është çelësi për të siguruar që objektivi i kauzës të ndiqet. Është gjithashtu e dobishme për të dokumentuar të gjithë punën në mënyrë që të kanalizohen së bashku strategjitë, sukseset dhe sfidat në organizimet e ardhshme.

### Përfundime dhe rekomandime

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*

Njohja me origjinën e aktivizmit dhe metodat më të përdorura në ditët e sotme ofron një busull orientimi për gjithë aktivistët e rinj të cilët kanë dëshirën e madhe, por janë ende të paqartë për të nisur aktivizmin e tyre. Në mënyrë që të kenë sukses të rinjtë duhet të jenë të mirëinformuar rreth platformave dhe mënyrave si përdoren.

Ka fushata specifike të cilat kërkojnë platformën e duhur. Aktivizmi sot është më i lehtë së më parë sidomos edhe me shfrytëzimin e platformave online, megjithatë duhet një koordinim mes natyrës së kauzës dhe platformave që mund të përdoren. Aktivistët e rinj së pari duhet të kordinojnë se për çfarë ata duan të veprojnë dhe se cilat janë fushat më shqetësuese e më tej të njihen me mjetet që mund ti ndihmojnë për të vepruar sa më shpejt dhe sa më sigurt në mënyrë që të kenë sukses. Çdo aktivitet duhet të jetë i përshtatur me specifikat e komunitetit lokal apo kombtar për të cilat të rinjtë duan të veprojnë.

Aktivizmi dixhital kërkon punë dhe kërkon punë të madhe dixhitale. Ai rrit potencialin e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së të rinjve dhe rrit mundësitë e tyre për të qënë qytetarë aktivë përmes mediave sociale dhe platformave virtuale, duke e kthyer nga një mënyrë komunikimi joformale në një mjet efektiv për transformimin social. Aktivizmi mund të nisë me hapa të vegjël duke vënë në dukje fillimisht angazhimin dhe devotshmërinë e aktivistëve.

Pavarësisht impaktit të madh të mjeteve digjitale të realizimit të tij aktivizmi mund të shfrytëzojë një gamë të gjerë metodash edhe të aktivizmit në terren për të patur sukses. Disa nga lëvizjet më të suksesshme përdorin mediat sociale dhe aktivitetin në internet për të mbledhur mbështetjen dhe më pas e kombinojnë këtë me punën në terren, jo vetëm duke folur, por edhe duke e ngritur planin në këmbë. Lëvizja e grevës për klimën 2019 është një shembull tepër i suksesshëm i kombinimit të aktivizmit online dhe offline. Duke u bashkuar pas Greta Thunberg dhe Fridays for Future miliona qytetarë në të gjithë botën janë mobilizuar për të adresuar krizën klimatike dhe për të mbështetur aktivizmin mjedisor. Njohja me këto metoda dhe orientimi i të rinjve rreth llojeve të aktivizmit dhe mënyrës së realizimit të tyre bën që ata të kenë një përgatitje më të madhe dhe rrit shanset për një aktivizëm adekuat. Falë këtyre faktorëve krijimtaria dhe puna e tyre pritet të ketë rezultate me një impakt në komunitet më pas duke sjellë që ata të bëhen pjesë edhe e shoqërisë civile në të ardhmen dhe të jenë mbi të gjitha qytetarë aktivë dhe kërkues për vendimarrësit në mënyrë që ata të kenë transparencë e llogaridhënie më të madhe në realitetin post-Covid.

*Projekti "Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë" mbështetet nga:*



*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*





## Referenca

### Burime Primare

- COE HRE and activism- COMPASS Manual for Human Rights Education with Young people <https://www.coe.int/en/web/compass/hre-and-activism>
- Libero-Manual for young activists-Bring it to play [http://libero.org.rs/wp-content/uploads/Bring-into-play\\_Libero\\_booklet.pdf](http://libero.org.rs/wp-content/uploads/Bring-into-play_Libero_booklet.pdf)
- Libero-Snap Activism Manual- [http://libero.org.rs/wp-content/uploads/SNAP\\_Activism\\_Toolkit.pdf](http://libero.org.rs/wp-content/uploads/SNAP_Activism_Toolkit.pdf)
- SALTO-YOUTH Training and Cooperation Resources, Tools for Learning in Non-formal Education
- Perspectives on youth - Volume 2 - Connections and disconnections CoE, 2015
- International Union of Socialists Youth-Young People in Action - <http://iusy.org/wp-content/uploads/2018/03/YPiA-Toolkit-EN.pdf>
- Advocates for Youth- Youth activists Toolkit: <http://www.advocatesforyouth.org/wp-content/uploads/2019/04/Youth-Activist-Toolkit.pdf>
- Psychology of Sustainability and Sustainable Development-Activism and Social Media: Youth Participation and Communication <https://www.mdpi.com/2071-1050/13/18/10485/htm>
- Does online activism work? Does it have a positive impact on society? <https://netivist.org/debate/online-activism-pros-and-cons>

*Projekti “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë” mbështetet nga:*